



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201400737/2**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014**

**Lënda:** *Rekomandim për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete".*

**Drejtuar :** **Z. Artan DIDI**  
**Drejtore i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**Tiranë**

**Për dijeni :** **Ministrit të Punëve të Brendshme**  
**Z. Saimir TAHIRI**

**Tiranë**

***Të nderuar Zotërinj,***

Në vijim të bashkëpunimit tonë të vazhdueshëm për përmirësimin e nivelit të zbatimit dhe respektimit të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve në përputhje me standardet ndërkombëtare po ju bëjmë prezent shqetësimin e mëposhtëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë rastin e bërë publik në media i cili bën fjalë për moslejimin për të dalë jashtë vendit nga Policia Kufitare dhe Migracionit të drejtuesve të mjeteve dhe të mjeteve të tyre që nuk kanë shlyer gjokat administrative ndaj Policisë së Shtetit.

Për të verifikuar këtë shqetësim publik, kohët e fundit jemi njohur me aktin administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Urdhrit Nr. 49, datë 10.01.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete".

Në pikën 1 të tij parashikohet se: *“Në Pikat e Kalimit Kufitar, nëpërmjet sistemit E-Gjoba, të bëhet verifikimi i të gjitha automjeteve që dalin nga Republika e Shqipërisë, për detyrimet e pashlyera ndaj Policisë së Shtetit lidhur me gjobat e vendosura për kundravajtje administrative, për të cilat ka kaluar afati i parashikuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”.*

Në pikën 2 të tij parashikohet se: *“Pas verifikimeve të kryera sipas procedurave standarde për daljen e shtetasve dhe automjeteve nga territori i Republikës së Shqipërisë, drejtuesit e automjeteve që rezultojnë debitorë, do të lejohen të vazhdojnë udhëtimin vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet e pashlyera në afat, ndaj Policisë së Shtetit”.*

Ndërsa në pikën nr. 3 të tij parashikohet se: *“Punonjësi i Policisë Kufitare dhe Migracionit do të lejohet daljen jashtë vendit shtetasin bashkë me automjetin, pas paraqitjes së faturës përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të verifikuara nga sistemi E-Gjoba ”.*

Nga përmbajtja e pikave 2 e 3 të këtij Urdhri rezulton në mënyrë të qartë se, *të gjithë shtetasit shqiptarë, drejtues të automjeteve, të cilët rezultojnë debitorë nuk do të lejohen të dalin jashtë vendit bashkë me automjetin nëse nuk kanë paguar të gjitha detyrimet e pashlyera në afat ndaj Policisë së Shtetit.*

Ne gjykojmë se, nga zbatimi i këtij Urdhri të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, shtetasve shqiptarë drejtues të automjeteve, të cilët rezultojnë debitorë ndaj Policisë së Shtetit lidhur me gjobat e vendosura për kundravajtje administrative, për të cilat ka kaluar afati i parashikuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë u mohohet e drejta themelore universale për të dalë lirisht jashtë shtetit e garantuar nga neni 38, paragrafi i dytë, i Kushtetutës tonë<sup>1</sup>; neni 13, pika 2, e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>2</sup>; dhe neni 2, pika 2, e Protokollit nr.4 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>3</sup>.

Ndërkohë ky urdhër vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 17 të Kushtetutës ku prashikohet se:

*“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuar në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përjestim me gjendjen që e ka diktuar atë.  
2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Me këtë rast dëshirojmë të theksojmë se, autoritetet shqiptare, pjesë e të cilave është edhe Policia e Shtetit, jo vetëm që nuk duhet të bëhen pengesë për realizimin e kësaj të drejte themelore universale të shtetasve të vet, por duhet të kontribuojë për respektimin e saj.

<sup>1</sup> Në nenin 38/2 të Kushtetutës tonë parashikohet se: *“Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit”.*

<sup>2</sup> Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë të largohet nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e tij, si dhe të kthehet në vendin e tij”.*

<sup>3</sup> Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë edhe të tijin”.*

Përveç sa më sipër theksojmë edhe një fakt shumë të rëndësishëm që kemi konstatuar gjatë trajtimit të këtij problemi, i cili ka të bëjë me pabazueshmërinë ligjore të Urdhrit Nr. 49, datë 10.01.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete”, sepse është nxjerrë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 118 të Kushtetutës i cili parashikon se:

- “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*
- 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*
- 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”.*

Nga referimi në urdhrin e cituar më sipër konstatojmë se, nxjerrja e tij është bazuar në nenin 20 të ligjit nr. 7947, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në nenin 105 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Adiministrative”. Mirëpo dispozitat përkatëse të këtyre dy ligjeve në të cilat është bazuar ky urdhër nuk autorizojnë nxjerrjen e këtij akti nënligjore, nuk përcaktojnë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt.

Gjithashtu ky urdhër është bazuar edhe në nenin 39 të “Rregullores së Brendshme të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm Nr. 1404, datë 09.12.2008.

Në nenin 119 të Kushtetutës parashikohet se:

- “1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre.*
- 2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.*
- 3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme”.*

Nga përmbajtja, urdhri i cituar më sipër është akt normativ me fuqi të përgjithshme sepse krijon pasoja juridike për një kategori shtetasish, drejtues të automjeteve të paidentifikuar në mënyrë nominative.

Ndërsa “Rregullorja e Brendshme e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm Nr. 1404, datë 09.12.2008 është një akt nënligjor me karakter të brendshëm dhe i detyrueshëm vetëm për njësinë administrative, organin e Policisë së Shtetit dhe punonjësit e saj.

Referuar nenit 119 të Kushtetutës rezulton se, urdhri në fjalë nuk është nxjerrë në përputhje edhe me këtë dispozitë kushtetuese sepse nuk është nxjerrë në bazë e për zbatim të një akti që ka fuqi juridike të përgjithshme sikurse kërkohet, por në bazë të një akti që ka karakter të brendshëm.

Ju sjellim në vëmendje nenin 203 të Kodit Rrugor ku është parashikuar e drejta e punonjësve të policisë për vjeljen e gjobave të cilat nuk janë paguar brenda afatit. Sipas pikës 1 të kësaj dispozite, *të ardhurat nga masat administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara nga nenet e këtij Kodi, paguhen nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon gjobë në vend. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj. Kur gjoba nuk paguhet ose nuk nxirret dot nga të ardhurat e shkelësit, për rastet e drejtuesit të mjetit me motor, bëhet ndalimi i mjetit deri në tre muaj dhe pas këtij afati bëhet shitja e mjetit me ankand, duke i dhënë diferencën në lekë shkelësit.* Sikurse rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite, Kodi Rrugor i cili është ligj i posaçëm për rregullimin e marrëdhënieve juridike në fushën e qarkullimit rrugor e ka rregulluar mënyrën e vjeljes së gjobave administrative kur ato nuk paguhen ose nuk nxirret dot nga të ardhurat e shkelësit. Për rrjedhojë nuk është e nevojshme nxjerrja e akteve të tjera normative nënligjore për mënyrën e vjeljes së gjobës nga shkelësi.

Gjithashtu ju kujtojmë se, “ndalimi i daljes jashtë shtetit” është një nga llojet e masave të sigurimit personal, masë shtrënguese, e parashikuar në nenin 232/1/a të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në bazë të nenit 233/1 të këtij kodi, kjo masë shtrënguese është e drejtë eskuzive e gjykatës dhe jepet ndaj të pandehurit.

Ne gjykojmë se nuk është normale që, në një shtet të së drejtës, organet shtetërore dhe në rastin konkret Policia e Shtetit për të realizuar vjeljen e një detyrimi administrativ ligjor që qytetari ka ndaj shtetit të shkelin një të drejtë kushtetuese të tij apo të përvetësojnë e ushtrojnë një tagër ligjor që me ligj i është dhënë një organi tjetër.

Për këto arsye duke iu referuar Kodit të Procedurave Administrative, respektivisht neneve 115/a dhe 116/c rezulton se, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete”, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Ju bëjmë me dije se, referuar nenit 117/1 të Kodit të Procedurave Administrative, ky akt administrativ (urdhër) nuk prodhon pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar apo jo si absolutisht i pavlefshëm.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 45/2/c të Kodit të Procedurave Administrative; nenit 117/2 të po këtij kodi ku thuhet se: “*Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me nismën e tij, mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë*”; nenin 63/3 të ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; si dhe nenin 21/b të ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati*

*i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete”.

2. Zbatimin e nenit 203/1 të Kodit Rrugor për vjeljen e gjobave administrative kur ato nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga të ardhurat e shkelësit.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**